



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa,Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail:info@vaudejes.gov.al)

PROPOZIM

"Për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës"

Komisioni i mandateve të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar , neni 49, pika 2,pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, i propozon Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

PROPOZOJMË

1.Miratimin e humbjes së mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës,Z.Aleko Dodani

Komisioni i Mandateve:

Z. Neki Kapllanaj – Kryetar _____

Z. Marin Dodaj – Sekretar _____

Znj. Edona Molla – Anëtar _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 25.11.2025

RAPORT VENDIMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 11 datë 10/11/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Tetor 2025"

Analiza ligjore:

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Situata aktuale e funksionit: --

Situata financiare : Projekt vendimi propozon që 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Tetor 2025 , familje 131, me 411.359 lekë, me 5.98% e fondit total. 2-Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Tetor 2025 janë shpallur fitues, 891 familje, me fond 6.864.461 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 411.867 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndhmes Ekonomike dhe PAK kane relatuar për projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 25/11/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.11 datë 10/11/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Tetor 2025"paraqitur nga sektori ndihmes ekonomike dhe PAK..

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Albina Livadhi _____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Meliha Zyberaj _____ **Zv.Kryetar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Sanije Salja _____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 25.11.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.16 datë 18.11.2025 "Për miratimin e së subvencionit të qirasë dhe vlerën e perfitimit për znj.Gjovana Marku (Peci) dhe z. Afrim Marku në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë"

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015" Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; nenit 38 i Ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social"i ndryshuar; VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; VKM-së nr.362 prot, datë 29.05.2019 "Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 "Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026" në Bashkinë Vau Dejës; VKB-së nr.40, datë 28.06.2021 "Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvencion i qirasë në tregun e lirë"; VKB Nr.21 me 26.03.2025 "Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit" VKB nr. 47, datë 26.06.2024 "Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave". Proces-Verbali i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datë 14.11.2025.

Situata financiare:

Vlera maksimale e subvencionit të qirës në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirës në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave dhe të ardhurave të familjes															
Nr Rendor	Emër	Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018	Për tërheqja Familjare	Struktura e Banesës (Apartamenti)	Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirës në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirës në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave VKB nr. 47; datë 26.06.2024	Qiraja reale	Të ardhurat Familjare mujore (neto)	Aftësia përballuese e(%)	Qiraja e përballueshme	Subvencioni në muaj	Subvencioni që mbulohet nga buxheti në Lek	Shuma që kërkohej nga buxheti i shtetit në Lek	Subvencioni në vit në Lek	
1	Gjovana	Marku	Familje pa të ardhura sipas nenit 2, pika 45 e ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social"	1	1+1		14,000	15,000	41.469	0.15	6220	8780.00	8780.00	0	105,360.00
Totali muaj:															



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vlera maksimale e subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave dhe të ardhurave të familjes

Nr. Rendori	Emër	Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018	Përfaqësimi Familjare	Struktura e Banesës (Shërbimi Private)	Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave VKB nr. 47, datë 26.06.2024	Qiraja reale	Të ardhurat Familjare majore (neto)	Afërsia përbalues s(%)	Qiraja e përbalueshme	Subvencioni në muaj	Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia në Lek	Shuma që kërkohet nga buxheti i shtetit në Lek	Subvencioni në vit në Lek
3	Afrim	Marku	Familje pa të ardhura sipas nenit 2, pika 45 e ligjit 22-2018 "Për Strehimin Social"	4	2+1	21,800	20,000	-	-	0	20000.00	20000.00	0	240,000.0
Totali muaj							20000.00	20000.00	20000.00	20000.00	20000.00	0	240,000.0	

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e mbrojtjes përfshirjes dhe strehimit social, sektori strehimit social.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e projekt vendimit dhe do të thërrasin sa herë të jetë e nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken:

Subvencioni i qirasë si një instrument i programit të banesave sociale me qira, mbështet individë familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë.

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 25/11/2025, shqyrtoi projekt vendimin nr.16 datë 18.11.2025 "Për miratimin e së subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për znj.Gjovana Marku (Peci) dhe z. Afrim Marku në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë"


Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- miratimin e projektaktit

Albina Livadhi  Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Meliha Zyberaj  Zv.Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Sanije Salja  Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisoni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit

Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 25.11.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për ndryshimin e vkb nr.84 datë 23.12.2024 "Për shtesën e tranfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës" sipas aktit normativ nr.10 datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 për buxhetin e vitit 2025".

Analiza ligjore:

Mbështetur në nenin 9, neni 34, 37, 40, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen 2025, me propozim të Kryetarit të vendore" i ndryshuar; neni 4, kreu III, nenet 10, kreu IV, nenet 22-24, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Ligjin 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimin Plotësues nr 1 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025, VKB-ne nr 84 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, Sipas Aktit Normativ nr 10, datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar sipas shkresës nr 14505/11 prot datë 24.10.2025 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr 10 datë 08.10.2025" dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës.

Situata aktuale e funksionit: Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 84 datë 23.12.2024 "Për shtesën e tranfertës së pakushtëzuar sektoriale të Bashkisë Vau Dejës, sipas Aktit Normativ nr.10 datë 08.10.2025" për Bashkinë Vau Dejës të konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresë nr 860/1 prot datë 06.01.2025.

Ministria e Financës me shkresën nr. 14505/11 Prot, datë 08.10.2025, me lëndë "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr 10 datë 08.10.2025", ka dërguar detajimin e shtesës së fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi Ky fond akordohet për ti ndihmuar bashkitë për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në shuarjen e zjarreve, në masën deri në një pagë.

Në shkresë cilesohet që për bashkitë që kanë akorduar shpërblimin e punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi nga buxheti i tyre do ta përdorin këtë fond për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Sipas Vendimit Nr. 483 datë 2.9.2025 PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PERSONELIT TË ANGAZHUAR NË OPERACIONET PËR SHUARJEN E ZJARREVE GJATË VITIT 2025, pika 9) Efekti financiar për strukturat e përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga buxhetet përkatëse



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

të njësive të vetëqeverisjes vendore, ne kemi përdorur fondet nga buxheti i bashkisë për kalimin e shpërblimeve të punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, konkretisht pagesat me urdhër shpenzimit nr 664 dhe urdhër shpenzimi nr 665. Bazur në aktin normativ nr.10 datë 08.10.2025, nëpërmjet këtij projekt vendimi është bërë angazhimi që këto fonde të kalojnë në llogarinë ekonomike 602 për shpenzimet operative, për programin 03280 që të përdoren në vazhdimësi për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit që mbulon ky program.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisionit

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt vendim ka për qëllim mbështetjen e punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Neki Kapllani _____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Arsen Mehmeti _____ **Zv.Kryetar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Florin Tanushi _____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 25.11.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për pranimin e të moshuares Znj..Age Tavasija në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

Analiza ligjore:

Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" në VKM-në 518, datë 04.09.2018" Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masen e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar " Kreu III Pika 13. A); pika 14; pika 17; pika 18; pika 23.a); pika 24; Kreu IV "Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes" Pika 58, c) pika 59; si dhe bazuar në formularin e verifikimit të gjendjes sociale ekonomike të të moshuarit:

Qëllimi i projekt vendimit: Mbështetur në kërkesën e paraqitur pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës të Znj..Age Tavasija për sistemimin e saj në qëndren për të moshuar "BESA" Barbullush, paraqitet propozimi për miratim . Znj..Age Tavasija është shprehur se jeton prej disa vitesh vetem ne shtepine e saj ne njesine administrative Shllak. Ajo ka berë kerkese qe te akomodohet ne qendren e te moshuarve barbullush pasi nuk munt e jetoje e vetme me ne fshat, si dhe pas vleresimit te situates sociale dhe shendetsores te znj.AGE TAVASIJA, konstatohet se ajo jeton ne kushte shume te veshtira ekonomike dhe nuk ka mbeshtetje familjare te mjaftueshme per kujdes te perdritshem.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e mbrojtjes, përfshirjes dhe strehimit social. Sektori i strehimit social.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken: Të moshuarve nga Qendra e Përkujdesit Rezidencial për të moshuar (Besa) Barbullush ju ofrohet:

Strehim

Ushqim

Përkujdesje Shëndetësore

Përkujdesje Social-Psikologjike

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 25/11/2025, shqyrtoi projekt vendimin e mësipërme dhe pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1.T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektakteve në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektakteve

Albina Livadhi  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Meliha Zyberaj  **Zv.Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Saniye Salja  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 25.11.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve:

-Projekt vendim "Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.46, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen prej 5 ha "Për aerogjeneratorë (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 3.909 km (3 km e 909 m) rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim, 6.709 km (6 km e 709 m) linjë transmetimi të energjisë elektrike në ekonomitë pyjore Gjadër Mnelë"

-Projekt vendim "Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin Nr.37, datë 24.05.2024 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 9 vjeçar sipërfaqen prej 0.5 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësorë, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojërash, mjedise sportive, shplothëse, kulturore, agroturizëm etj) në ngastrën 3b ekonomia Gjadër Mnelë"

-Projekt vendim "Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.44, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar për aerogjeneratorë sipërfaqe prej 5.3 ha dhe 5.258 km rrugë për lidhje me sipërfaqen në ekonominë pyjore Gjadër Mnelë"

-Projekt vendim "Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.45, datë 29.08.2025 të Këshillit Bashkiak "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqes prej 3 ha "Për aerogjeneratorë (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 4.063 km (4 km e 63 m) rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonomitë Gjadër Mnelë".

Analiza ligjore

-Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenit 27 pika 5, nenit 54 germa "e/I", neni 18 të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; neni 25 pika 1/c e Ligjit Nr. 57/2020 "Për pyjet" neni 17/3 ligjin nr. 9693 date 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar me Ligjin nr.111/2024 "Për disa ndryshime ne ligjin nr. 9693 date 19.03.2007 "Për fondin kullosor"; pikën 49, të VKM-së nr.433 datë 08.06.2016, pika nr.2 germa a,e,d dhe pika 7 të Udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"; shtojca 3 e VKM nr.467 datë 31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme" VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtarë, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusorë Pyjore"; Shtojca 1 pika 8, pika nr.11,pika 13 ,VKB-në Vau Dejës nr.46, datë 29.08.2025.

-Mbështetur në nenin 9 pika 1.2 germa "a", neni 18, nenit 27 pika 5, nenit 54 germa "e/T", nenit 55 pika 3, neni 64 germa "c", të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 25 pika 1 germa a të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", pikën 49,



shtojca 47 të VKM-së Nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive dhe kullotave publike, sipas listës së inventarëve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" i ndryshuar; VKM-së Nr.748, datë 01.12.2022 "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore" dëgjësës publike datë 15.12.2023; shtojcën nr.1 pika 6/3 të VKM-së Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtarë, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore"; VKB Nr.7, datë 26.01.2024 "Mbi miratimin e listës së ngastrave/nengastrave pyjore të gatshme për dhënien në përdorim"; pika Nr.2 germa (a) dhe pika nr.7 Udhëzimin nr.1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", pas rregjistrimit të pronës në ASHK dhe mos përputhjes me sipërfaqen e dhënë me qira.

-Mbështetur në nenin 9 pika 1.2 germa "a", nenit 27 pika 5, nenit 54 germa "e/I", neni 18 të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; neni 25 pika 1/c e Ligjit Nr. 57/2020 "Për pyjet"; pikën 49, të VKM-së nr.433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarëve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndryshuar; pika nr.2 germa a/c/e dhe pika 7 të Udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik"; Shtojca 1 pikat 8, pika 11 e VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtarë, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore Pyjore", i ndryshuar, VKB-në Vau Dejës nr.44, datë 29.08.2025 "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar për aerogjeneratorë sipërfaqe prej 5.3 ha dhe 5.258 km rrugë për lidhje me sipërfaqen në ekonominë pyjore Gjadër Mnelë

-Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenit 27 pika 5, nenit 54 germa "e/I", neni 18 të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; neni 25 pika 1/c e Ligjit Nr. 57/2020 "Për pyjet" neni 17/3 ligjin nr. 9693 date 19.03.2007 "Për fondin kullësor", i ndryshuar me Ligjin nr.111/2024 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9693 date 19.03.2007 "Për fondin kullësor"; pikën 49, të VKM-së nr.433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarëve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndryshuar; pika nr.2 germa a,e,d dhe pika 7 të Udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik"; shtojca 3 e VKM nr.467 datë 31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme" për dhënien në përdorim të sipërfaqes për ngastrën nr. 53 kullote, VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtarë, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore Pyjore"; Shtojca 1 pika 8 për ngastrat nr. 65 djerr, 83 cungishte dhe pika nr.11 për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim; VKB-në Vau Dejës nr.45, datë 29.08.2025 "Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 3 ha "Për aerogjeneratorë (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 4.063 km (4 km e 63 m) rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gjadër Mnelë".

Situata aktuale e funksionit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Administrimi i Aseteve publike në territorin e Bashkisë është një ndër funksionet e Bashkisë.

Peojekt vendimet paraqiten për efekt të ndryshimit të procedurave ku në ndryshim nga Vkb e marra, duhet të ndiqet procedura për dhënie në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik mbështetur në Ligjin nr.57/2020 „Për pyjet“,ndërsa për sipërfaqen 0.5 ha do të jepet në përdorim vetëm sipërfaqja prej 0.3 ha e cila është e çertifikuar.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimeve do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Rrit nivelin e të ardhurave të Bashkisë si dhe krijon mundësinë për punësim të banorëve të Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

3. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Kastriot Shkja _____ **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Mirela Vasija _____ **Zv.Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Aleko Dodani, Sekretar i Komisionit (humbë mandati para kohe)
(emri, mbiemri, firma)